The paper also explores the ethical implications of SR, such as concerns about data privacy, bias in training datasets, and the need for inclusive systems that cater to diverse linguistic and cultural communities.

To gather insights on these issues, a survey was conducted among students of this field, teachers of foreign languages, and translators or interpreters in Albania. The survey results highlighted the challenges of using SR systems in translation and interpretation, especially concerning dialectical variations, accuracy, and trust in the technology. By proposing a hybrid model that combines the speed of SR technology with human oversight, the paper suggests a balanced approach to improving accuracy, especially in critical environments.

Ultimately, the paper emphasizes the importance of developing culturally sensitive SR systems to ensure equitable access and avoid exacerbating social disparities.

Keywords: *Speech Recognition, Dialects, Ethics, Inclusivity*

Koutroumpi EIRINI, Milioni GEORGIA

National and Kapodistrian University of Athens

irenekoutroubi@gmail.com

MIDWAY UPON THE JOURNEY OF TRANSLATION: DIGITAL INSIGHTS INTO
DANTE'S DIVINE COMEDY

Abstract

The intersection of translation studies and digital humanities provides innovative methodologies for comparative textual analysis. This study examines how computational tools can improve the understanding of linguistic transformations in translation, by analyzing the original Italian text of Dante Alighieri's Divine Comedy alongside an English translation. Using Python-based text analysis and Voyant Tools, the research identifies and compares the most frequent and unique words in both versions, highlighting lexical shifts, semantic patterns, and stylistic adaptations introduced through translation.

By applying text-processing techniques such as tokenization, lemmatization, and frequency analysis, the research explores how meaning, emphasis, and poetic structure remain consistent or undergo transformation in translation. The findings contribute to discussions on equivalence, the degree of fidelity in translation, cultural mediation, and the role of digital methodologies in translation studies. Furthermore, this approach emphasizes the significance of computational tools in literary and linguistic research, aligning with the broader topics of translation in the digital age. Beyond demonstrating the potential of technology in translation research, it also raises questions about the evolving relationship between human interpretation and digital analysis.

Keywords: *Computational linguistics, translation analysis, Divine Comedy, text processing, lexical comparison.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Valdet BICI, Iris KLOSI

University of Tirana, Subsidiary Saranda, Faculty of Foreign Languages

valdet.bici@unitir.edu.al

TRANSLATING CULTURAL HERITAGE TERMINOLOGY IN COASTAL TOURISM: THE
CASE OF ALBANIA'S SOUTHERN COASTLINE

Abstract

This paper explores the translation of cultural heritage terminology in the context of coastal tourism along Albania's southern coastline, spanning from Vlora to Saranda. The study focuses on the linguistic, conceptual, and contextual challenges associated with translating materials that promote the region's rich heritage, including tangible and intangible elements such as historical landmarks, archaeological sites, traditional customs, local craftsmanship, and the unique environmental significance of nature parks and monuments.

Given the increasing importance of cultural tourism in Albania, accurate and culturally sensitive translations are essential for ensuring that international visitors gain a deeper understanding of the historical and cultural identity of the region.

The paper identifies key terminology necessary for translators and tour guides who serve as mediators between local heritage and foreign audiences. These terms encompass architectural descriptions, culinary traditions, historical references, and narratives that define the authentic character of the region.

Furthermore, the study highlights the impact of translation choices on the perception and appreciation of cultural heritage, emphasizing the need for standardized terminology that maintains historical accuracy while remaining accessible to diverse audiences. By analyzing existing translations and proposing best practices, the paper aims to contribute to improved translation strategies that enhance visitor engagement, support sustainable tourism development, and preserve the unique cultural identity of Albania's southern coastline.

Keywords: *Cultural heritage translation, coastal tourism, Albania's southern coastline, tangible and intangible heritage, translation strategies.*

Anna MARKOVA

Sofia University "St. Kliment Ohridski"

amarkova@uni-sofia.bg

SUR LA TRADUCTION DES REALIA ET RÉGIONALISMES TERMINOLOGIQUES DANS
LES DICTIONNAIRES ÉLECTRONIQUES BILINGUES

Resumé



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

La communication se propose d'explorer les modalités de mise en place de la traduction dans une langue étrangère, proposée par les dictionnaires électroniques bilingues dans le cas d'un lexique de spécialité d'un profil particulier, à savoir les termes culturellement ou géographiquement marqués. À partir d'un corpus de dénominations terminologiques d'établissements de restauration en français, constitué par le dépouillement de sources en ligne et imprimées (dictionnaires, sites institutionnels et commerciaux de restauration, publications et blogs spécialisés dans le tourisme), seront recherchées, dans 4 dictionnaires et bases lexicales en ligne bilingues (Larousse, Reverso, Linguee, WordRef), les équivalents anglais de quelque 40 termes realia et régionalismes (croissanteire, frierie, galetterie, bouchon, estaminet, winstub etc.), avec une attention particulière sur les procédés lexicographiques et traductologiques spécifiques mis en œuvre grâce aux fonctionnalités du support électronique. À la lumière des travaux théoriques sur les mécanismes de traduction de cette catégorie de termes, il s'agira de voir en quoi les ouvrages lexicographiques en format électronique suivent ou se distinguent des démarches connues et référencées et quelle structure peut adopter l'article lexicographique en ligne dans ce cas concret. Ces observations permettront de conclure sur le potentiel des dictionnaires électroniques de faciliter la transposition dans une langue étrangère des realia et des régionalismes terminologiques, d'optimiser le travail du traducteur sur ce type de lexèmes et de rendre compréhensible aux yeux du locuteur étranger, usager de la traduction, leur composante culturelle et/ou territorialement circonscrite.

Mots-clés: *realia et régionalismes terminologiques – restauration – dictionnaires électroniques – traduction – article lexicographique*

Mimoza HASANI PLLANA, Lindita SEJDIU RUGOVA

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

mimoza.hasani@uni-pr.edu

**TRANSFORMIMI I PËRKTHIMIT NË EPOKËN E DIGJITALIZIMIT – KRAHASIM I
PËRKTHIMIT TË TEKSTEVE LETRARE DHE JOLETRARE**

Abstrakt

Ky punim synon ta analizojë procesin e përkthimit të teksteve duke e krahasuar përkthimin bashkëkohor nëpërmjet përdorimit të aplikacioneve digjitale me përkthimin klasik (përkthimi manual) të realizuar nga përkthyesi njeri. Analiza do të mbështetet në krahasimin e përkthimit të teksteve letrare dhe jo-letrare në kontekstin e epokës digjitale, duke e theksuar rëndësinë e përkthyesit / redaktorit gjuhësor klasik në krahasim me përdorimin e aplikacioneve të ditëve të sotme si dhe të programeve përkatëse kompjuterike. Sfondi teorik mbështetet në literaturën shkencore të teoricientëve të përkthimit, si: Eugene Nida, Peter Newmark, Jean-Paul Vinay dhe Jean Darbelnet. Nga tekstet letrare në studim, do të analizohen përkthimet e poezive të poetes amerikane Sylvia Plath, duke krahasuar përkthimin e tyre nëpërmjet përdorimit të aplikacioneve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

digjitale dhe të përkthimit klasik (pa i përdorur teknologjitë e avancuara të sotme si: machine translation MT, post-editing, PE, artificial intelligence AI, etj.), ndërkaq krahasimi i përkthimeve me dhe pa teknologji i teksteve jolettrare do të përfshijë tekste nga gjyqësori dhe gjuha administrative. Rezultatet e krahasimit me kufizimet dhe lehtësimet e mundshme të të dyja mënyrave dhe formave të përkthimit do të diskutohen gjerësisht, duke i marrë parasysh edhe tiparet që përkthimet e caktuara i kanë në favor ose jo të përkthimit digjital.

Fjalë kyçe: përkthimi letrar, përkthimi jo-letrar, digjitalizimi, fjalorët, aplikacionet digjitale

Alma KARASALIU

Universiteti Fan S Noli, Korçë

akarasaliu@unkorce.edu.al

**SACRED WORDS, SILENT STRUGGLES: TRANSLATING CULTURAL AND RELIGIOUS
REFERENCES IN KIZIL GONCALAR**

Abstract

This study explores the challenges involved in translating the Turkish series Kızıl Goncalar, focusing on its cultural and religious elements. With the series yet to be translated into Albanian and English, this analysis investigates how translators need to carefully consider cultural references, religious terminology, and socio-cultural concepts within the series. Prominent expressions among which “hatun me katun”, which refers to a punishment within the sect’s practices imposed on women who have committed significant transgressions, pose significant challenges in translation. The paper examines how such terms are rendered in translation, considering the strategies used to preserve, adapt, or omit them for the target audiences. By analyzing examples taken from different scenes of both seasons, the paper highlights how translators handle the balance between cultural specificity and accessibility. The findings reveal that translating cultural and religious content presents unique difficulties, particularly when balancing the need for accessibility with the preservation of cultural authenticity. Furthermore, attention will be paid to the implications of translation choices in maintaining cultural integrity and ensuring that viewers from different cultural backgrounds can engage meaningfully with the material. The study also highlights the critical role of paratexts in bridging cultural gaps and suggests that audiovisual translators need to be culturally sensitive to effectively mediate between source and target audiences.

Key words: *Audiovisual Translation, Cultural Adaptation, Religious Terminology, Paratext, Intercultural Communication*

Asta PUKIENĖ

Kauno kolegija Higher Education Institution, Lithuania

asta.pukiene@gmail.com



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE**

**THE TRANSLATOR'S DILEMMA: PRESERVING ALLUSIONS AND CULTURAL
REFERENCES IN MASS MEDIA OR ADAPTING TO AUDIENCE
EXPECTATIONS?**

Abstract

Allusions and cultural references have always been important in literature, acting as effective stylistic means that strengthen the emotional, descriptive, and communicative function of the text. Nowadays allusions have successfully found their way into new areas such as mass media, social media, journalism, and the press. Text creators of non-fiction products refer to allusions as the short and sweet way to make their message more intriguing, informative, and persuasive to the reader. The aim of the current research is to reveal the tendencies of translation practice of allusions used in contemporary English news articles, focusing on how these stylistic elements are adapted to maintain their effectiveness and meaning across different languages and cultures.

Keywords: allusion, translation strategies, cultural adaptation, intertextuality, media discourse

Dr Martin MATO

Universiteti i Tiranës

martin.mato@unitir.edu.al

**RRAFSHET STILISTIKORE NË PËRKTHIMIN E VEPRËS "ZGJERIMI" TË ROBERT
MENASSES**

Abstrakt

Ky punim shqyrton rrafshet stilistikore në përkthimin e romanit Die Erweiterung (Zgjerimi) të Robert Menasses, duke u përqendruar në sfidat dhe nuancat që lindin nga ndërthurja e elementeve historike, politike dhe kulturore në kontekstin evropian. Nëpërmjet një analize krahasimore të tekstit burimor dhe versionit të përkthyer në shqip, studimi eksploron se si konceptet kyçe, si identiteti evropian, burokracia e BE-së dhe trashëgimia historike e Europës Juglindore, përkthehen dhe interpretohen për një audiencë të re gjuhësore.

Duke marrë parasysh kompleksitetin e diskursit politik dhe ironinë karakteristike të Menasses, analiza fokusohet në mënyrën se si strukturat stilistike, regjistrat gjuhësorë dhe aluzionet kulturore përshtaten ose transformohen gjatë procesit të përkthimit. Gjithashtu, trajtohen çështjet e ekuilibrit mes besnikërisë ndaj tekstit burimor dhe natyralizimit për lexuesin shqiptar, duke vlerësuar ndikimin që këto zgjedhje kanë në perceptimin e narrativës dhe mesazhit të autorit.

Studimi synon të kontribuojë në diskursin mbi përkthimin e letërsisë bashkëkohore evropiane në shqip, duke ofruar një qasje ndërdisiplinore që ndërthur stilistikën, përkthimësinë dhe studimet kulturore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Fjalë kyçe: *stilitika, Robert Menasse, Zgjerimi, diskurs politik, burokracia e BE-së, ndërmjetësimi kulturor,*

Jonida BUSHI, Alma KOSOVA, Ema KRISTO

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
jonida.bushi@unitir.edu.al

**SFIDAT E PËRKTHIMIT TË TERMINOLOGJISË MJEKËSORE: NDËRMJET
STANDARDIZIMIT TERMINOLOGJIK DHE PRAKTIKËS KLINIKE**

Abstrakt

Përkthimi i terminologjisë mjekësore përbën një fushë thellësisht të ndërlikuar brenda përkthimit të specializuar, ku saktësia terminologjike, koherenca konceptuale dhe përshtatshmëria kontekstuale janë elementë thelbësorë për garantimin e sigurisë së pacientit dhe integritetit të komunikimit ndërprofesional. Ky studim synon të shqyrtojë sfidat më të shpeshta me të cilat përballen përkthyesit gjatë transferimit të teksteve mjekësore nga gjermanishtja në shqip dhe anasjelltas, përfshirë dokumentacionin klinik, diagnozat, protokollet terapeutike dhe udhëzimet për përdorimin e medikamenteve.

Nëpërmjet një analize krahasuese të korpuseve autentike në të dyja gjuhët, trajtohen dukuri si: sinonimia e pjesshme, mungesa e ekvivalentëve të drejtpërdrejtë, si dhe nevoja për transformim sintaksor për të ruajtur funksionin komunikativ dhe përputhshmërinë e tekstit përkthyer. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të standardizimit terminologjik nëpërmjet përdorimit të fjalorëve mjekësorë, databazave shumëgjuhëshe dhe mjeteve të inteligjencës artificiale, të cilat ndihmojnë në garantimin e saktësisë dhe koherencës së përkthimit.

Punimi argumenton se përkthimi mjekësor duhet trajtuar jo vetëm si një akt gjuhësor, por si një ndërveprim kompleks ndërdisiplinor, ku përkthyesi pozicionohet si ndërmjetës midis dijes shkencore dhe praktikës klinike. Në këtë kontekst, kompetencat terminologjike dhe etike të përkthyesit marrin një rëndësi të veçantë, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Fjalë kyçe: *përkthimi mjekësor; terminologji; gjermanisht-shqip; standardizim; inteligjencë artificiale; komunikim ndërdisiplinor; analiza kontrastive.*

Alba FRASHËRI, Kamela MARKU,

Universiteti i Tiranës,
alba.frasheri@unitir.edu.al

NDËRMJETËSIMI KULTUROR DHE SFIDAT E PËRKTHIMIT NË FUSHËN E TURIZMIT



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Abstrakti

Turizmi është një sektor në zhvillim të vazhdueshëm që lidhet ngushtë me përkthimin, sidomos në përkthimin e guidave turistike, por jo vetëm. Ky lloj përkthimi i përket përkthimit të teksteve të specialitetit, ku përkthyesi duhet të përcaktojë tipologjinë e tekstit dhe të zgjedhë strategjinë përkatëse sipas kontekstit komunikues. Përkthimi po bëhet një faktor shumë i rëndësishëm promovues në këtë realitet të karakterizuar nga diversiteti dhe ndarja kulturore. Përkthimi turistik kërkon njohuri të thella gjuhësore dhe kulturore, pasi përkthyesi luan rolin e ndërmjetësit kulturor. Ai duhet të përshtatë tekstin për publikun e gjuhës pritëse, duke ruajtur funksionin informues dhe promovues të tekstit origjinal.

Në këtë proces do të analizojmë strategji të ndryshme përkthimore që mund të përdoren nga përkthyesi. Gjithashtu, do të analizojmë rëndësinë që kanë parametrat jashtëtekstualë dhe brendatekstualë, si struktura, niveli leksikor, funksioni i tekstit etj. Lidhja mes gjuhës dhe turizmit është e pandashme, pasi gjuha e transformon një vend të panjohur në një destinacion tërheqës. Puna parapërkthimore, si hartimi i skedave terminologjike, përbën një fazë të rëndësishme të procesit të përkthimit dhe ndihmon në saktësinë dhe qartësinë e përkthimit. Përkthyesi duhet të jetë kërkues, analitik dhe i aftë të menaxhojë aspektet gjuhësore dhe kulturore të tekstit.

Fjalë kyçe: *ndërmjetësim kulturor, përkthim, turizëm, strategji përkthimore.*

CULTURAL MEDIATION AND THE CHALLENGES OF TRANSLATION IN THE
TOURISM SECTOR

Abstract

Tourism is a continuously evolving sector that is closely linked to translation, particularly in the translation of tourist guides, though not exclusively. This type of translation falls within the field of specialized translation, where the translator must identify the text typology and select the appropriate strategy based on the communicative context. In today's world - marked by diversity and cultural fragmentation - translation is becoming a crucial promotional tool.

Tourist translation demands extensive linguistic and cultural competence, as the translator serves as a cultural mediator. Their task is to adapt the text for the target audience while preserving the original's informative and promotional functions.

In this context, we will examine various translation strategies available to the translator. Furthermore, we will explore the significance of both extratextual and intratextual parameters, such as text structure, lexical level, and communicative function. The relationship between language and tourism is inseparable, as language transforms an unfamiliar place into an appealing destination.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE**

Pre-translation tasks - such as compiling terminology sheets - represent a vital stage in the translation process and contribute to the clarity and accuracy of the final text. A translator must be inquisitive, analytical, and capable of navigating both linguistic and cultural dimensions of a text.

Keywords: *cultural mediation, translation, tourism, translation strategies.*

Irena KAPO (PATA), Sonila HASMUJAJ,
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës,
irena.pata@unitir.edu.al

**ANGLICIZMAT E DUKSHËM E TË PADUKSHËM TË PËRKTHYER DHE PËRSHTATUR
(OSE JO) NË SHQIPE**

Abstrakt

Ndikimi në rritje i anglishtes në shqipe gjatë dekadave të fundit ka shtuar dhe numrin e huazimeve të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta nga anglishtja. Shumë prej tyre janë të dallueshme apo lehtësisht të identifikueshme por ka dhe shumë anglicizma të tjerë të padukshëm të cilët duhen kërkuar mes kalkeve ose strukturave të huazuara në shqipe të cilat kanë hyrë tashmë në përdorim të gjerë, si në gjuhën e shkruar ashtu dhe atë të folur. Fokusi i këtij punimi do jenë së pari identifikimi i këtyre kalkeve me origjinë nga anglishtja, kryesisht nga baza e të dhënave të GLAD ku një nga autoret e punimit ka depozituar anglicizma të shqipes marrë kryesisht nga shtypi i shkruar. Rastet e identifikuara do të klasifikohen në kalke, gjysëm kalke dhe krijime apo përshtatje; dallimi mes tyre do bëhet bazuar në ngjashmërinë formale apo tek ndryshimi mes huazimit të papërshtatur nga anglishtja dhe gjegjëses në gjuhën e synuar (Pulcini 2023: 121).

Mënyra si janë përshtatur në shqipe por edhe bashkëjetesa ose jo e tyre me gjegjëset e tyre në anglishte apo dhe në shqipe do jetë një drejtim tjetër i hulumtimit në këtë punim. Përshtatja ose jo në shqipe e huazimeve të drejtpërdrejta nga anglishtja është një pjesë tjetër e rëndësishme e vëzhgimit dhe e studimit në këtë punim. Me qëllim që të shihen sfidat që hasen në përkthimin apo përshtatjen në shqipe të këtyre huazimeve do merren shembuj konkretë nga artikuj në shtypin e huaj (në fusha të ndryshme semantike) që janë përkthyer në shqipe. Tek shembujt e marrë do synohet të shihen dhe ‘ndryshimet në tentativë’ që prurjet nga anglishtja kanë shkaktuar e po vazhdojnë të shkaktojnë në strukturën sintaksore e morfologjike të shqipes. **Fjalë kyçe:** *kalke, anglicizma të dukshëm, anglicizma të padukshëm, përshtatja në shqipe*

**VISIBLE AND INVISIBLE ANGLICISMS TRANSLATED AND ADAPTED (OR NOT)
INTO ALBANIAN**

Visible and invisible anglicisms translated and adapted (or not) into Albanian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

The increasing influence of English on Albanian over the last decades has also increased the number of direct and indirect borrowings from English.

Many of them are distinguishable or easily identifiable, but there are also many other invisible anglicisms that must be sought among the calques or loanwords in Albanian that have already entered into widespread use, both in written and spoken language. The focus of this paper will be first to identify these calques of English origin, mainly from the GLAD database where one of the authors of the paper has deposited anglicisms of Albanian taken mainly from the printed press. The identified cases shall be classified into three categories: loan translations, loan renditions and loan creations, with distinctions drawn based on the formal similarity or divergence between the English etymon and its replica (Pulcini 2023: 121).

The way they have been adapted to Albanian, but also their coexistence or not with their English or Albanian counterparts, will be another direction of research in this paper. The adaptation or not of direct borrowings from English to Albanian is another important part of the observation and study in this paper. In order to see the challenges encountered in the translation or adaptation of these borrowings into Albanian, concrete examples will be taken from articles in the foreign press (in different semantic fields) that have been translated into Albanian. In the examples taken, it will also be aimed to see the 'tentative changes' that the contributions from English have caused and continue to cause in the syntactic and morphological structure of Albanian.

Keywords: *calques, visible anglicisms, invisible anglicisms, adaptation into Albanian*

Marsela Likaj

Universiteti i Tiranës

marsela.likaj@unitir.edu.al

NGA SHQIPJA NË BOTË: SFIDAT E PËRKTHIMIT LETRAR SI PROCES
NDËRKULTUROR – SHEMBUJ NGA PËRKTHIME TË AUTORËVE SHQIPTARË NË
GJUHËN GJERMANE

Abstrakt

Kjo kumtesë trajton përkthimin letrar nga gjuha shqipe në gjuhë të huaja – me fokus në përkthimet në gjuhën gjermane – si një proces kompleks ndërkulturor që shkon përtej përkthimit të thjeshtë gjuhësor. Duke u mbështetur në raste konkrete si veprat e Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, Fatos Kongolit, Arian Lekës, Stefan Çapalikut etj. kumtesa analizon mënyrën se si kultura shqiptare transmetohet dhe perceptohet nga lexuesi gjerman. Diskutimi fokusohet në sfida të rëndësishme të përkthimit si përkthimi i realiteteve historike dhe politike, ruajtja e stilit individual dhe



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

figuracionit letrar, përshtatja e referencave kulturore, si dhe ndikimi i ideologjisë dhe politikave editoriale.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të përkthyesit si ndërmjetës kulturor dhe si ndërtues i një "imazhi të përkthyer" të Shqipërisë. Përmes këtij shqyrtimi, kumtesa thekson rëndësinë e përkthimit letrar në promovimin e dialogut ndërkulturor dhe në vendosjen e letërsisë shqiptare si pjesë aktive e hapësirës letrare globale.

Fjalë kyçe: *përkthim letrar, kultura shqiptare, përkthyesi si ndërmjetës, sfida ndërkulturore, letërsi shqipe në gjuhë të huaja, përkthim në gjermanisht, identitet kulturor*

Osman GASHI

Universiteti i Prishtinës

osman.gashi@uni-pr.edu

**PËRKTHIMI - AKTIVITET GJUHËSOR DHE TRANSFORMIM SEMIOTIK I NJË TEKSTI
Abstrakt**

Përkthimi është një veprimtari shumë e rëndësishme në jetën e njeriut e përgjithësisht të shoqërisë njerëzore, që nuk kufizon vetëm me domenin kulturor e artistik, por përfshin edhe shumë fusha tjera si atë, sociale, politike, psikologjike, religjioze, historike e përgjithësisht kognitive.

Duke qenë se në thelbin e tij, përkthimi ka të bëjë me gjuhën apo me gjuhët, po kështu duhet studiuar para së gjithash kontekstin apo dimensionin gjuhësor të tij.

Zhvillimi në kohë dhe hapësirë i shoqërisë njerëzore, sidomos ai kulturor e ka shpërfaqur dhe e ka dëshmuar faktin se pa përkthime historia do të ishte e mangët, fragmentare, e copëzuar e herë herë edhe jo ekzistuese.

Kumtesa ime synon të trajtojë në kontekstin diakronik dhe sinkronik çështjen e përkthimeve në fushë të letërsisë, me fokus të veçantë tek letërsia shqiptare e shekullit XIX dhe XX.

Fjalët çelës: *Teori e praktikë përkthimi, Letërsia nacionale, Letërsia botërore, Të lexuarit*

Leonita PARALLANGAJ

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

lindita.tahiri@uni-pr.edu

**VËSHTRIM KRAHASUES MES DY PËRKTHIMEVE TË NIKOS KAZANTZAKIS-IT NË
SHQIP**

Abstrakt

Çështja e përkthimit dhe interesimi për problemet e kalimit nga një gjuhë në një tjetër janë shqetësime të hershme të kulturave të ndryshme. Qasja gjuhësore ndaj çështjeve të përkthimit është pa dyshim, themelore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Ajo çka përbën rëndësi të veçantë për studimin tonë është çështja e përkthimit të veprës letrare, mbrojtja e tekstit të përkthyer dhe e tekstit burimor, studimi i versioneve në gjuhë të ndryshme, të një teksti të shkruar dhe studimi i shumë versioneve në të njëjtën gjuhë ku janë përkthyer, të të njëjtit tekst burimor.

Përkthimin e bëjnë objekt shqyrtimi në këtë punim për disa arsye. Nga më kryesoret është padyshim rrugëtimi që bëjnë vepra letrare nga një gjuhë në tjetrën, qoftë në rrafshin gjuhësor dhe tematikë, qoftë të mënyrës së shprehjes së tekstit e të shprehurit poetik.

Në këtë studim do të vëmë në punë të gjitha mjetet metodologjike, të ofruara prej shkencave të gjuhës. Do të gjenden të cituar autorë, vepra, punime studimore, të cilat na kanë ndihmuar për të nxjerrur në pah të gjitha çështjet e shqyrtuara në çdo pikëpamje: shkencore, kulturore dhe didaktike.

Fjalë kyçe: *tekst i përkthyer, tekst burimor, përkthyes, shtrembërime, strategji e përkthimit.*

Abstract

The question of translation and the interest in the problems of switching from one language to another are early concerns of different cultures. The linguistic approach to translation issues is undoubtedly fundamental.

What is of special importance for our study is the issue of the translation of the literary work, the protection of the translated text and the source text, the study of versions in different languages of a written text and the study of many versions in the same language where they have been translated, of the same source text.

We made the translation the subject of consideration in the paper for several reasons. One of the most important is undoubtedly the journey made by literary works from one language to another, either in terms of language and subject matter, or the way of elaborating the text and poetic.

In this study, we will use all the methodological tools offered by the language sciences.

Authors, works, research papers will be cited, which have helped us to highlight all the issues examined in every point of view: scientific, cultural and didactic.

Keywords: *translated text, source text, translator, distortions, translation strategy.*

Sotiria LETO ALEXAKI

Ionian University, Greece

lito_alexaki@ionio.gr

COMPARATIVE STUDY OF IMPORTANT GREEK TRANSLATIONS FROM THE 18TH
AND 19TH CENTURIES

Abstract



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

This study explores the contribution of Artificial Intelligence (AI) to the comparative analysis of translations into Greek of important works of global literature from the 18th and 19th centuries. Translation research has traditionally relied on philological and interpretative approaches; however, the advancement of AI allows for the automated analysis of large translation corpora, offering new possibilities for the study of linguistic and stylistic changes.

The research focuses on texts that played a key role in shaping modern Greek language and thought. By using tools provided by AI, a faster study of large-scale translations of world literature is achieved, improving not only the accuracy and consistency of comparative analysis but also enabling a deeper understanding of the long-term translation trends.

The study highlights the importance of AI as a decisive tool in modern translation studies, as it expands methodological approaches and enhances the efficiency of analysis in large and diverse text corpora. The use of AI allows for the mapping of translation strategies from different historical periods and a better understanding of the cultural, ideological, and linguistic influences that shaped the translations. Thus, this work emphasizes the usefulness of AI as an integral tool in Translation Studies, contributing to the evolution of the field and opening new horizons.

Keywords: *Artificial Intelligence (AI), Translation Studies, Comparative Analysis, Linguistic Evolution, Translation Strategies*

Leonard RAPI

University of Gjirokaster, Albania

nardirapi@yahoo.com

AN INVESTIGATION OF TRANSLATION SHIFTS IN THE TRANSLATION INTO
ALBANIAN OF TWO SHORT STORIES FROM JAMES JOYCE'S "DUBLINERS"

Abstract

A critical assessment of the translation into Albanian of two short stories from James Joyce's "Dubliners" reveals a considerable number of translation shifts, many of whom seem to be cases of over-translations. The translator often makes use of explicitation, which is adding other linguistic items that do not occur in the source text. Furthermore, instead of opting for the obvious equivalent, the translator occasionally employs idiomatic expressions to render them into Albanian. There are also cases of shifts which, in our opinion, could amount to misinterpretations on the part of the translator.

In this article we discuss the above issues by analyzing the data at our disposal as well as offer some tentative explanations about the cause of such translational choices.

Keywords: *translation shifts, idiomatic expressions, obvious equivalent, explicitation, translation behavior*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE
NJË VLERËSIM KRITIK I PËRKTHIMIT NË SHQIP TË DY TREGIMEVE TË SHKURTRA
NGA LIBRI “DUBLINASIT” I AUTORIT IRLANDEZ, XHEIMS XHOIS

Abstrakt

Një vlerësim kritik i përkthimit në shqip të dy tregimeve të shkurtra nga libri “Dublinasit” i autorit irlandez, Xheims Xhois, zbulon një numër të konsiderueshëm shmangjesh përkthimore. Këto shmangje mund të konsiderohen më së shumti si raste mbipërkthimi. Përkthyesi përdor teknikën përkthimore të shpjegimit me anë të njësive gjuhësore shtesë të cilat nuk figurojnë në tekstin origjinal. Gjithashtu, në vend të përkthimit me barazvlerësin e drejtpërdrejtë në gjuhën shqipe, përkthyesi herë herë shfrytëzon shprehje idiomatike. Ekzistojnë gjithashtu raste shmangjesh të cilat, në gjykimin tonë, mund të përbëjnë raste keqinterpretimi nga ana e përkthyesit.

Në këtë artikull diskutohen çështjet e mësipërme duke analizuar të dhënat e gjetura si dhe synohet të jepen disa shpjegime të mundshme për shkaqet e këtyre zgjedhjeve përkthimore.

Fjalë kyçe: *shmangje përkthimore, shprehje idiomatike, barazvlerës, shpjegim, sjellje përkthimore*

Dr. Granit ZELA

University of New York Tirana

granitzela@unyt.edu.al

PËRKTHIMI NË SHQIP I UILLIAM FOLKNERIT: NJË FENOMENOLOGJI E PËRKTHIMIT
AUTORIAL

Abstrakt

Punimi shqyrton së pari me historinë e përkthimeve të Folknerit në gjuhën shqipe duke nisur nga përkthimi i hershëm i romanit “Këlthitja dhe mllëfi” në Kosovë në vitin 1893 e deri më sot. Në pikëpamje të kontekstit historik dhe kulturor shqiptar të para vitit 1990-të, Folkneri ishte një shkrimtar që mishëronte letërsinë “dekadente”, një referencë nga “kritika borgjeze dhe revizioniste” që e bënte të pamundur përkthimin në Shqipëri, por jo në Kosovë dhe gjithashtu nuk përjashtoni ndikimin e tij në letrat shqipe të identifikuar nga studiuesit në “universin narrativ” të Ismail Kadarese (të quajtur Ismailand). Së dyti, hidhet dritë në përpjekjet e ndryshme të botimit dhe qasjet e përkthimit të përkthyesve të ndryshëm shqiptarë për të sjellë tekstet e Folknerit në kulturën shqiptare. Këto përkthime u bënë pjesë e gjuhës së synuar duke u përballur me sfida të shumta; praktikatat e ndërlikuara botuese paskomuniste; me skepticizmin e përkthimeve të teksteve të Folknerit nga lexuesit dhe bota e qarqeve akademike. Së treti, diskutohen zgjedhjet specifike të bëra në versionet auoriale të përkthimit të romanit “Dritë e gushtit”, (Onufri 2017) dhe të përkthimit të rishikuar në vitin 2021. Këto përvoja përkthimore të dorës së parë e çojnë autorin në përfundimin se përkthimi i tij i Folknerit ishte fenomenologjik, i formuar nga këta përbërës; formimi kulturor dhe akademik, niveli i njohjes me tekstet e ndërlikuara të Folknerit, studimi i



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

analizës së përkthimeve në gjuhë të tjera, aftësia për të zotëruar burime të ndryshme të gjuhës shqipe; praktikat editoriale të shtëpisë botuese shqiptare dhe interesi i publikimit, përvoja e përgjithshme e përkthyesit dhe aftësia për të krijuar një autoritet dhe personalitet publik si ndërmjetës i besueshëm i teksteve të Folknerit në kulturën shqiptare. Së fundi, mungesa e përgjithshme e përkthimeve të Folknerit në Shqipëri, megjithëse ka pasur përpjekje të mëdha për t'i bërë tekstet e Folknerit pjesë të kulturës shqiptare, ajo është ende e paplotë dhe një punë në proces.

Fjalët kyçe: *Uiljam Folkner, përkthimet në shqip, personaliteti i përkthyesve, praktikat e botimit.*

WILLIAM FAULKNER'S TRANSLATION INTO ALBANIAN: AUTHORIAL
TRANSLATION PHENOMENOLOGY

Abstract

The paper firstly examines the history of Faulkner translations into Albanian language from the early translation of the novel “Këlthitja dhe mllëfi” (The Sound and the Fury) in Kosova in 1893, to the present. In the context of the Albanian historical and cultural context before 1990s Faulkner was a writer that embodied the “decadent” literature, a reference by “bourgeois and revisionist criticism” that made impossible translation into Albania but not in Kosovo and also did not exclude his impact in Albanian letters identified by scholars in the “narrative universe” of Ismail Kadare (named Ismailand). Secondly, it sheds light on different publication efforts and translation approaches of various Albanian translators to bring Faulkner texts in Albanian culture. These translations became part of the target language by facing numerous challenges; the complex post – communist editorial practices; the skepticism of Faulkner’s translations by the readers, and world of academia. Thirdly, it discusses specific choices made in his own translation versions of the novel “Dritë e gushtit”, Light in August (Onufri 2017) and its translation revision in 2021. These first hand translation experiences lead the author to the conclusion that his translation of Faulkner was phenomenological, shaped by these components; cultural and academic background, level of familiarity with complicated Faulkner texts, study of translations analysis in other languages, capacity of mastering various sources of the Albanian language; the Albanian publishing house editorial practices and publication interest, the overall translation experience of the translator, and ability to establish an authority and public personality as reliable mediator of Faulkner texts to Albanian culture. In the end, the overall lack of Faulkner translations in Albania although it has acknowledged great efforts to make Faulkner texts part of the Albanian culture, still it is uncompleted and a work in progress.

Keywords: William Faulkner, Albanian translations, translators’ personality, editorial practices.

Elham JASHARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Universiteti i Tiranës

Elhamjashari07@gmail.com

NDIKIMI I TEKNOLOGJISË NË TEORITË E PËRKTHIMIT

Abstrakt

Në dekadat e fundit, zhvillimi i teknologjik ka ndryshuar praktikën e përkthimit letrar, si dhe mënyrën se si përkthyesit dhe studiuesit e përkthimit i qasen koncepteve ekzistuese në kuadër të teorive përkatëse. Tradicionalisht, përkthimi letrar është parë si një ndërthurje e kreativitetit, kuptimit kulturor dhe stilit, por sot ai përballlet me sfida dhe mundësi të reja të shkaktuara nga teknologjia. Ky punim shqyrton ndikimin e pajisjeve teknologjike të avancuara, si mjetet ndihmëse kompjuterike për përkthim (CAT tools), sistemet e përkthimit makinerik, bazat e të dhënave leksikore dhe korpuset dixhitale, mbi disa nga teoritë kryesore të përkthimit letrar, të cilat përfshijnë teorinë e ekuivalencës, funksionalizmin, teorinë e polisistemit dhe modelet përshkruese. Kërkimi synon të kuptojë sesi këto teknologji kanë transformuar procesin e marrjes së vendimeve nga përkthyesit letrarë, shkallën e lirisë së tyre në përpunimin e informacionit dhe marrëdhënien e tyre me tekstin burimor dhe atë synues. Për më tepër, ky punim analizon idenë se rritja e varësisë ndaj teknologjisë po çon drejt një zhvendosjeje drejt qasjeve integruese që ndërthurin funksionet e përkthyesit njerëzor me ato të teknologjisë. Studimi synon të tregojë, përmes një analize kritike, se disa konstrukione klasike të teorisë në fushën e përkthimit letrar kanë nevojë për t'u rishikuar në raport me botën dixhitale dhe hiper-realitetin, duke theksuar nevojën urgjente për modele hibride që i përgjigjen ndryshimeve që i ndodhin praktikës së përkthimit në epokën e teknologjisë dixhitale të avancuar dhe automatizimit.

Fjalë kyçe: *përkthimi letrar, teknologjia, kuadri teorik, kreativiteti në përkthim, automatizimi në përkthim.*

THE EFFECTS OF TECHNOLOGY ON TRANSLATION THEORIES

Abstract

In the past few decades, the development of technology has changed the practice of literary translation as well as the way translators and translation scholars approach the existing concepts in theoretical frameworks. Traditionally poetic translation is seen as a combination of creativity, cultural understanding, and style, but now faces additional challenges and opportunities coming from technology. This paper investigates the influence of advanced technological devices such as Computer-Assisted Translation (CAT) tools, machine translation systems, lexical databases, and digital corpora on some of the main theories of literary translation, which include theorized equivalence, functionalism, polysystem theory, and descriptive models. The research aims at



REPubLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

understanding how these technologies have transformed the decision making of literary translators, their degree of freedom in the information movement, and their relationship to the source and target texts. Moreover, this paper analyzes the idea that increasing dependency on technology is leading towards a shift in the integrationist approaches which merge the functions of human translators with those of machines. This study attempts to show through an analysis that some classical constructs of theory in the field of literary translation need to be re-thought with regard to the digital world and the hyper-reality, emphasizing the most obvious need for blended models which accommodate the changes that occur to the practice of translation in the age of advanced digital technology and automation.

Key words: *Literary translation, technology, theoretical frameworks, creativity in translation, automation in translation*

Eldonita GUCIA, Shqipe GASHI

Universiteti i Prishtinës

eldonitagucia@gmail.com

ANALIZË DHE KRAHASIM I PËRKTHIMIT TË POEZISË SE HEINRICH HEINE

Abstrakt

Ky punim shqyrton përkthimin e poezisë së Heinrich Heine, duke u fokusuar në krahasimin e përkthimeve të realizuara nga përkthyes të ndryshëm. Përmes një analize stilistike dhe letrare, synohet të kuptohet se si ndryshojnë interpretimet dhe qasjet e përkthyesve në përcjelljen e mesazhit, ritmit dhe ndjeshmërisë poetike të poezisë së Heine-së. Duke marrë parasysh kompleksitetin e gjuhës dhe simbolikën e thellë të tij, studimi eksploron sfidat kryesore që paraqet përkthimi i një poezie të tillë dhe strategjitë që përdoren për të ruajtur sa më shumë nga origjinali.

Një aspekt inovativ i këtij punimi është krahasimi midis përkthimeve tradicionale dhe një përkthimi të krijuar nga inteligjenca artificiale. Për këtë qëllim, poezia e zgjedhur e Heine-së është përkthyer me ndihmën e një modeli të avancuar të inteligjencës artificiale dhe më pas është krahasuar me përkthimet klasike. Kjo analizë synon të zbulojë dallimet mes qasjes njerëzore dhe asaj algoritmike, duke shqyrtuar elemente si ritmi, ndjeshmëria poetike, saktësia semantike dhe ruajtja e stilit origjinal.

Gjetjet e studimit tregojnë se ndërsa përkthyesit njerëzorë sjellin një interpretim më nuancuar dhe estetikisht të pasur, inteligjenca artificiale ofron një qasje më të strukturuar, por shpesh të kufizuar në aspektin emocional dhe stilistik. Në përfundim, punimi sugjeron se përkthimi i poezisë mbetet një proces artistik që kërkon ndërhyrje dhe intuitë njerëzore, ndërkohë që teknologjia mund të shërbejë si një mjet ndihmës, por jo zëvendësues i përkthyesit letrar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEGA KUALIFIKIMIT DHE BOTIMEVE SHKENCORE

Fjalët kyçe: Heine, Përkthimi klasik, Përkthim AI, gjermanisht, shqip.

ANALYSIS AND COMPARISON OF THE TRANSLATION OF HEINRICH HEINE

Abstract

